



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Teori Përkthimi

Ngarkesa: 4 kredite (= 40 orë mësimore); 3 Kredite Leksion (= 30 orë mësimore); 1 Kredit seminar (= 10 orë mësimore)

Viti / Semestri : Viti III, semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Bachelor ‘Përkthim dhe Interpretim’

Kodi i Etikës: Kodi i Etikës, Universiteti i Tiranës (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Të pajisë studentët me njohuri teorike dhe praktike për përkthimin si proces dhe si produkt në dy gjuhë: anglisht dhe shqip. Të ndërtojë ndërgjegjësim mbi lidhjen midis përkthimit, gjuhës, kulturës dhe studimeve ndërdisiplinore. Të aftësojë studentët për të trajtuar përkthimin në nivel mikro dhe makro, duke respektuar strukturën, stilin dhe funksionin e tekstit.

Objektivat specifike lëndore :

1. Të zhvillojnë aftësi për të analizuar dhe përkthyer tekste të ndryshme sipas stileve funksionale, veçanërisht në fushën e medias.
2. Të zbatojnë strategji për përballimin e problemeve përkthimore që lidhen me strukturën gramatikore, leksikore dhe stilistike të dy gjuhëve.
3. Të integrojnë kompetenca gjuhësore, kulturore dhe kërkimore për një qasje të plotë dhe profesionale ndaj përkthimit.

Rezultatet e pritshme :

1. Studentët do të jenë të aftë të manipulojnë dhe përkthejnë tekste të niveleve të ndryshme të vështirësisë, duke ruajtur funksionin komunikativ të tyre.
2. Do të kuptojnë dhe aplikojnë teoritë dhe teknikat përkthimore në mënyrë kritike dhe të vetëdijshme.
3. Do të integrojnë përkthimin në kontekste të ndryshme mësimore dhe profesionale, duke pasur parasysh natyrën ndërdisiplinore të komunikimit.